



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, Datë _____.____. 2018

**PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE TË BASHKËPUNIMIT MIDIS ADMINISTRATORËVE TË
NDËRTESAVE TË BANIMIT, NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE
POLICISË SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Administratorët e ndërtesave të banimit, bashkëpunojnë me strukturën vendore të Policisë së Shtetit, për zbatimin e masave shtesë të sigurisë në ndërtesat e banimit, pas marrjes së vendimit të miratimit nga asambleja e bashkëpronarëve, sipas ligjit “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, për rritjen e sigurisë së jetës së shtetasve, të pronës së tyre dhe për parandalimin e ngjarjeve kriminale.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me strukturën vendore të Policisë së Shtetit, për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
3. Struktura vendore e Policisë së Shtetit bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me administratorët e ndërtesave të banimit, për çështjet e mëposhtme:
 - a. për kryerjen e analizës së vlerësimit të riskut bazuar në faktorët përkatës, të përcaktuar në ligj;
 - b. për identifikimin e ndërtesave të banimit, për të cilat duhet të merren masa shtesë të sigurisë;
 - c. për njoftimin e subjektit nga struktura vendore e Policisë së Shtetit për gjendjen e rrezikut dhe nivelin e masave shtesë të sigurisë që duhet të marrë, brenda 5 ditëve nga kryerja e vlerësimit;
 - d. për pajisjen e objektit me vërtetim sigurie.

4. Administratori i njësisë së vetëqeverisjes vendore, administratorët e ndërtesave të banimit dhe punonjësi i Policisë së Shtetit (Shefi i Seksionit të Policimit në Komunitet / Ndhmës Specialisti i Policimit në Komunitet), organizojnë takime periodike, por jo më pak se një herë në tre muaj, për shkëmbim informacioni, njohje me problemet dhe shqetësimet reciproke, si dhe për caktimin e masave për zgjidhjen e tyre.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe administratorët e ndërtesave të banimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

FATMIR XHAFAJ

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË BASHKËPUNIMIT MIDIS ADMINISTRATORËVE TË NDËRTESAVE TË BANIMIT, NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE POLICISË SË SHTETIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave për bashkëpunimin e Policisë së Shtetit me njësitë e vetëqeverisjes vendore, administratorët e ndërtesave të banimit, për të cilat ka një vlerësim lidhur me rrezikun e mundshëm të dëmtimit nga veprimtari kriminale e shkelës të tjerë të ligjit.

Objektivi kryesor që synohet me miratimin e këtij projektvendimi është zbatimi i ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, nëpërmjet koordinimit të veprimeve të strukturave policore me administratorët e ndërtesave të banimit dhe me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe rritja e standardeve të sigurisë, në të gjithë vendin dhe në veçanti parandalimi i ngjarjeve kriminale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në Programin Analitik të Përgjithshëm të Projektakteve, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2017.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë periudhës së tranzicionit, si rezultat i lëvizjes së lirë të njerëzve, pati ndryshime të mëdha demografike, sidomos në zhvendosjen nga zonat rurale të largëta në zonat urbane, drejt qyteteve kryesore të vendit, ku krahas kultivimit të indiferencës në popullsinë vendore, për konstatime për shkeljet ligjore e vepra

kriminale të kryera nga persona në lagje, ka patur edhe rritje të problemeve në zonat e banuara.

Në këto kushte, është e domosdoshme rritja e masave shtesë të sigurisë publike, duke bërë të mundur një bashkëveprim të koordinuar midis strukturave të policisë së shtetit, përgjegjëse për sigurinë, bashkive si njësi bazë të vetëqeverisjes vendore, të përfaqësuar nga administratorët e njësive administrative, si dhe administratorët e ndërtesave të banimit, sipas rastit shoqëritë e administrimit të ndërtesave të banimit apo pronarët e tyre.

Ky projektvendim përcakton rregullat e bashkëpunimit midis subjekteve të parashikuara në nenin 6, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, duke sanksionuar detyrimin për bashkëpunim dhe duke përcaktuar çështjet për të cilat do të bashkëpunohet.

Njëkohësisht ky projektvendim bën të mundur që të zbatohet edhe Strategjia e Policimit në Komunitet, filozofia e së cilës është pjesëmarrja e institucioneve dhe komunitetit, në zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe të rendit, sidomos në fushën e parandalimit të veprimtarisë kriminale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me legjislacionin vendas, si dhe është hartuar në zbatim të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim, megjithëse është hartuar mbi bazën e eksperiencës së vendeve të zhvilluara evropiane, nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përcakton fushat e bashkëpunimit, të lidhura këto ngushtësisht me misionin dhe fushën e përgjegjësisë që ka çdo strukturë apo subjekt, si administratori i pallatit / shoqëritë e administrimit të pallateve apo ndërtesave të banimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore (administratorët e njësive administrative vendore), si dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit, në zbatim të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Policia e Shtetit, në zbatim të ligjit nr.19/2016, si dhe të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, merr përsipër të ndihmojë me atributet që ka, në monitorimin e masave shtesë të sigurisë publike, që në themel synojnë rritjen e sigurisë së komunitetit dhe cilësinë e bashkëjetesës, ruajtjen e pronës dhe kryesisht parandalimin në kohë të çdo ngjarjeje kriminale që mund të shqetësojë komunitetin.

Në pikën 1, të nenit 6, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, është parashikuar marrja e masave shtesë të sigurisë publike nga administratorët e ndërtesave të banimit, në ambientet e përbashkëta të banimit, me marrjen e vendimit të miratimit nga asambleja e bashkëpronarëve, sipas legjislacionit në fuqi. Në nenin 33, të ligjit nr.10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, është përcaktuar kurumi i nevojshëm për të marrë vendime nga asambleja, që kanë të bëjnë me ambientet e përbashkëta të banimit.

Në pikën 1.24, të udhëzimit nr.134, datë 10.3.2017, të Ministrisë të Punëve të Brendshme “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”, është përcaktuar se:

“Pas dakordësimit me banorët e pallatit, administratorët e pallateve në bashkëpunim edhe me banorët marrin këto masa shtesë sigurie:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/Server deri në dy muaj me fushëpamje në hyrje/dalje të pallatit.”

Në zbatim dhe duke respektuar parashikimet ligjore të cituara më lart, ky projektvendim përcakton rregullat e bashkëpunimit, ndërmjet administratorëve të ndërtesave të banimit, njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit.

Ky projektvendim përbëhet nga 5 pika.

Në pikën 1, të projektvendimit përcaktohet se administratorët e ndërtesave të banimit, bashkëpunojnë me strukturën vendore të Policisë së Shtetit, për zbatimin e masave shtesë të sigurisë, në ndërtesat e banimit, pas marrjes së vendimit të miratimit nga asambleja e bashkëpronarëve, sipas ligjit “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, me qëllim rritjen e sigurisë së jetës së shtetasve, të pronës së tyre dhe për parandalimin e ngjarjeve kriminale.

Në pikën 2, përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me strukturën vendore të Policisë së Shtetit, për zbatimin e dispozitave të ligjit

nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike" dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Në pikën 3, janë përcaktuar çështjet për të cilat bashkëpunon struktura vendore e Policisë së Shtetit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me administratorët e ndërtesave të banimit. Këto çështje janë:

- a. kryerja e analizës së vlerësimit të riskut bazuar në faktorët përkatës, të përcaktuar me ligj (neni 7, i ligjit nr.19/2016);
- b. identifikimi i ndërtesave të banimit, për të cilat duhet të merren masa shtesë sigurie;
- c. njoftimi i subjektit nga struktura vendore e Policisë së Shtetit për gjendjen e rrezikut dhe nivelin e masave shtesë të sigurisë publike që duhet të marrë, brenda 5 ditëve nga kryerja e vlerësimit;
- d. pajisja e objektit me vërtetim sigurie.

Në pikën 4, është përcaktuar se administratori i njësisë së vetëqeverisjes vendore, administratorët e ndërtesave të banimit dhe punonjësi i Policisë së Shtetit (Shefi i Seksionit të Policimit në Komunitet / Ndhmës Specialisti i Policimit në Komunitet), organizojnë takime periodike, por jo më pak se një herë në tre muaj, për shkëmbim informacioni, njohje me problemet dhe shqetësimet reciproke, si dhe për caktimin e masave për zgjidhjen e tyre.

Në pikën 5, të projektvendimit janë përcaktuar institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektvendimi dhe që janë: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe administratorët e ndërtesave të banimit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohet Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe administratorët e ndërtesave të banimit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga një grup pune i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Me shkresën nr.3713/1 Prot, datë 15.05.2017, ky projektvendim i është dërguar për mendim, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrit të Shtetit për Çështjet

Vendore dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat më përjashtim të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, janë shprehur dakord me miratimin e këtij projektvendimi.

Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nuk ka kthyer përgjigje për shkresën e dërguar për mendim. Në këto kushte, në kuadër të procesit të konsultimit publik, ky projektvendim dhe relacioni shpjegues i tij, i janë dërguar në mënyrë elektronike për mendim, shoqatave të të zgjedhurve vendorë dhe Bashkisë së Tiranës, nëpërmjet Koordinatorit për Konsultimin Publik, të cilët edhe pas kalimit të afateve ligjore nuk kthyen përgjigje.

Sugjerimi i Ministrisë së Drejtësisë, për ripunimin e projektvendimit në përputhje me autorizimin ligjor, duke rregulluar çështjet që ka deleguar ligji nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, si dhe duke përcaktuar rregulla për bashkëpunimin të lidhura me masat shtesë të përcaktuara në nenin 8 të ligjit, është reflektuar si në projektvendim, ashtu dhe në relacionin shpjegues.

Megjithatë, në lidhje me këtë sugjerim, vlen të përmendim se në pikën 1.24, të udhëzimit nr.134, datë 10.3.2017, të Ministrit të Punëve të Brendshme “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”, është përcaktuar se:

“Pas dakordësimit me banorët e pallatit, administratorët e pallateve në bashkëpunim edhe me banorët marrin këto masa shtesë sigurie:

a) Instalojnë sistem me kamera të tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/Server deri në dy muaj me fushëpamje në hyrje/dalje të pallatit.”

Ky përcaktim është bërë në zbatim të pikës 2, të nenit 8 të ligjit nr.19/2016.

Pra, duke qenë se është përcaktuar tashmë me një akt nënligjor, sipas delegimit përkatës të ligjit, **lloji i masës së sigurisë** që do të merret nga administratorët e ndërtesave të banimit, që është *kamera e tipit CCTV, me rezolucion të lartë, me rreze infra të kuqe dhe që ruajnë imazhet filmike në NVR/Server deri në dy muaj*, objekt i këtij projektvendimi është vetëm përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit për zbatimin e detyrimeve ligjore, nëpërmjet koordinimit të veprimeve të strukturave të Policisë së Shtetit me administratorët e ndërtesave të banimit dhe me përfaqësuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore, për çështjet e përcaktuara në këtë projektvendim.

Me shkresën nr.3713/7 Prot., datë 23.10.2017, ky projektvendim dhe relacioni shpjegues, të ripunuara, i janë ridërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, e cila me shkresën nr.3261/3 Prot., datë 30.10.2017 është shprehur dakord.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk paraqet efekte financiare shtesë për Buxhetin e Shtetit, pasi qëllimi i tij është të përcaktojë rregullat e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Shtetit, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe administratorëve të ndërtesave të banimit, në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe ka karakter teknik.

PROPOZUESI

MINISTRI

FATMIR XHAFAJ